



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	28-07-23	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		370/01-18379 Y.	

KONTRATA PËR PUNË

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Shefket Koxha – Menaxher i prokurimit**; në njërën anë dhe

"Plus Trade" LLC nga Ferizaji (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga i autorizuari **Përparim Dalloshi** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

"Rregullimi në rrjetin egzistues të ndriqimit publik"

me numër Identifikues **KA652/23-6854-5-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të **"Rregullimi në rrjetin egzistues të ndriqimit publik"**.

1.2 Kontrata hynë në fuqi **31.07.2023**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **20 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **Varrezat e qytetit Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë **LPP-04/L-042**. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **6.592.30 €; me fjalë (Gjashtëmijepesëqindendhjetedyeuro e 30 centë.)**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të punëve nga na e menagjerit të projektit si dhe komisionit për pranimit të punëve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 00 muaj, pas pranimit të **punëve**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa parajykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo

nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.


Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Përparim Dalloshi	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Pronar	Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	28.07.2023	Data:	28.07.2023
Vula:		Vula:	

Paramasa dhe parallogaria për rregullimin e rrjetit të ndriçimit publik në komunën e Kaçanikut

Nr.I	pershkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Furnizimi dhe montimi Kablloz 3x2.5 mm ² ,Cu	m'	85.00	1.00	85.00 €
2	Furnizimi dhe montimi Siguresa Automatike 32 A	copë	10.00	2.20	22.00 €
3	Furnizimi dhe montimi Siguresa Automatike 16 A	copë	10.00	2.20	22.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i llampave LED për ndriçim publik të tipit DORADA DR-72-60W ose të ngjashme . Llampat të jenë sipas detalit të dhënë - Luminous flux: 13400 lm, - Color Temperature: neutral white 3000K - URCE: LED diodes of constant, eye-friendly neutral white color temperature (4200K), superior performance and rated lifetime L70 of 50 000 hours. Para vendosjes ato duhet të miratohen nga organi mbikëqyrës.	copë	200.00	18.50	3,700.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i llampave LED për ndriçim publik të tipit DORADA DR-72-100W ose të ngjashme . Llampat të jenë sipas detalit të dhënë - Luminous flux: 13400 lm, - Color Temperature: neutral white 6000K - URCE: LED diodes of constant, eye-friendly neutral white color temperature (4200K), superior performance and rated lifetime L70 of 50 000 hours. Para vendosjes ato duhet të miratohen nga organi mbikëqyrës.	copë	50.00	30.00	1,500.00 €
6	Furnizimi dhe montimi i Kabllos PP-OO A 4x16mm ² AL (nëntokësor) me papuqe adekuate për montim dhe vazhdim.	m'	150.00	2.50	375.00 €
7	FID 40 A	copë	1.00	40.00	40.00 €
8	Kontaktor -40,500V,40 A	copë	1.00	45.00	45.00 €
9	Kapak Sigurues mbrojtës pvc-plastike	copë	205.00	2.65	543.25 €



<p>KSHE, me dimensione 1200x600x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, tabela duhet te jete metalike e galvanizuar, siq eshte pershkuar ne pershkrim teknike. Karakteristikat teknike: Enclosure series CDC and SDC are made of galvanized steel sheet and with the performance standards ISO 1461, IEC 61439-1, IEC 61439-5.</p> <p>Element perberse jane:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Nderperes magneto termike AS-160/R63A, 3p, Icc=10kA. 2. Njehsor matese i energjise 3f, 80A, per matje dirkete 3. Siguresa automatike 3p, C, 20A , Icc=6kA=4set. 4. Konkator 3p, 230V, 25A modulare =4cope. 5. Nderperes (0,1,2), 2p, 16A=2cope. 6. Digital time switch with an astronomical program SHT-4 =1pcs 7. Siguresa automatike 6A,1p, C, Icc=6kA. 8. Materiali i imet lidhes. 9.Në llogari 	<p>10</p>	<p>hynë edhe mihja dhe betonimi i themelit të copë</p>	<p>1.00</p>	<p>260.00</p>	<p>260.00 €</p>
				<p>Totali:</p>	<p>6,592.3 €</p>

P.S. Para fillimit te punimeve tokësore , punëkryesi është I obliguar që ti njoftojë me shkrim: KEDS-in,PTK, Ndërmarrjen Publike" Bifurkacioni për fillimin e punimeve me qellim të evitimit të dëmtimit të infrastrukturës përkatëse ,dhe për çdo dëmtim të infrastrukturës pasojat financiare i bartë ekzekutuesi i punimeve dhe është i obliguar që ti sanoj defektet e mundshme. Në çmim të përfshihet furnizimi montimi dhe përdorimi i autokorpës për montimin e këtyre elementeve(realizimin e pozicioneve)

Kaçanik, 2023

E PUNUAR NGA: Arian Teneqja

